

BASHKIM HOXHA
BALADA E PIRATIT DHE POETIT
ROMAN

BOTIMET TOENA

BASHKIM HOXHA

BALADA E PIRATIT
DHE POETIT

roman

BOTIMET TOENA

Botuese: Irena Toçi

Redaktor: Behar Gjoka

Përkujdesja grafike *dhe* kopertina: Gea Qëndro

ISBN

© AUTORI *dhe* BOTIMET TOENA

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollesha", nr. 71, Tiranë 1023

ose K. Postare 1420

Tel.: +355 67 70 70 884

botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

Pen/g,-gu emër i gjinisë mashkullore; numri
shumës; -gje(t)

*... rob që mbahet për ta përdorur si mjet shkëmbimi me
dikë tjetër: lirimi i pengjeve.*

**... merak i madh për diçka që s’kam mundur ta
bëj: e kam peng në zemër.**

Nga FJALORI I GJUHES SHQIPE

1.

Dita sapo ka nisur të zbardhë, kur Xhemal Syçi niset për tek kulla e drunjtë e farit.

Ai kështu bën çdo mëngjes herët që kur është larguar nga lundrimi për shkak të pleqërisë.

Zë pozicionin më të lartë.

Atje ku duket pika më e largët.

Atje ku qielli dhe deti bëhen një.

Pastaj, me një tejqyrëse të vendosur mbi syrin e pataposur, vrojton horizontin në gjysmë rrotullim.

Vetëm njërin sy e ka të hapur, tjetrin e ka të mbyllur me një rreth gome të zi.

E ka lënë në luftë.

Kontrollon në horizont shfaqjen e anijeve; kur ndonjë afrohet, i bie fort kambanës.

Është sinjali i shumëpritur, të cilin çdo herë, veshëngritur, e pret i gjithë fshati.

Tanimë nuk flasin, nuk pëshpërisin kur ai ngjit i heshtur shkallët në mëngjes.

Por kur e panë për herë të parë të kontrollonte horizontin, shumë njerëz u çuditën.

Me një sy?

Si mund t'i besojmë lajmin e shumëpritur njeriut me një sy dhe syrin tjetër të taposur?

Por ai u mbylli gojët dyshuese me pak fjalë.

Një herë foli dhe nuk i përsëriti më:

“A nuk e mbyllim të gjithë njërin sy kur syrin e hapur e vendosim në tejqyrëse?”

*A dini përse ndodh kjo?
Me njërin sy vrojtohet më mirë thellë në largësi.
Syri i dytë të shpërqendron shikimin.”*

Me të rënë këmbana, gratë dhe fëmijët mbushin sheshin e vogël ndanë skelës.

Shfaqen me vrap për të ndjekur më nga afër afrimin rrëshqitës të velës mbi valë.

Lëkundja e anijes nëpër dallgë drejt bregut mund të zgjasë edhe gjysmë dite që nga momenti kur shfaqet.

Por ata nuk largohen.

Presin.

Ka ditë kur njerëzit shfaqen aty në shesh edhe pa rënë këmbana.

Afrohen te deti në mëngjes herët; bëjnë sikur u ka rënë rruga buzë detit.

Disa gra të lodhura bëjnë sikur kanë dalë shëtitje për të marrë pak ajër të pastër.

I ka lodhur nata.

Të gjithë këta kinse kalimtarë sytë i kanë nga deti.

Atje tej.

Atje ku syri i vetëm i Xhemal Syçit nuk ka mbërritur.

Duket fare qartë që kanë dalë të presin.

Ka ditë që sheshi mbushet plot edhe pa rënë këmbana.

Dhe kjo ndodh sepse pritja e gjatë dhe shpresa vrasin gjumin.

Janë përpëlitur në shtrat.

Sy mbyllur—zgjuar.

Jetojnë me mend ditën e re që do të vijë.

Besojnë një shpresë që u shfaqet pa formë,
urrejnë tik-takun e sahatit dhe mërmërisin fjalë
mallkimi për këmbanat që heshtin.

Gratë u besojnë parandjenjave të tyre më shumë
sesa vështrimit të Xhemalit, sipas tyre të mangët.

Në shumicën e rasteve ato zhgënjehen, por nuk
duan t'ia dinë.

Nuk e marrin parasysh që askush nga ata që
presin nuk vjen.

Dalin heshturazi në pritje edhe në mëngjesin
tjetër.

Presin deri në fund të ditës.

Presin.

Në këto raste, Xhemal Syçi zbret shkallët
e kullës së drunjtë në fund të ditës si një fajtor, i
heshtur.

Ka ndjesinë se është ai që i ka prerë gjuhën
këmbanës që s'bën zë.

Ecën kokëulur, pa hedhur vështrime rreth e
qark.

Dhe, ndërsa e ndjekin fytyrat e trishtuara e të
mërzitura të grave dhe fëmijëve, përsërit pothuajse
të njëjtën shprehje — e thënë në mbrëmje të
ndryshme me fjalë të ndryshme:

*“Unë vërtet jam me një sy, por shoh më mirë sesa shihni
ju me dy sy nëpër ëndrra.*

Mësojeni, o njerëz: ëndrrat janë dëshirat tuaja të fshehta.

Ëndrrat nuk dalin.

Jetojnë vetëm natën.

Dita i vret në mëngjes.”

Ose: “ikni në shtëpi, nuk vjen njeri sot.

Ju gratë gjithmonë keni vështrim më të gabuar.

Vështrimi juaj nuk e kapërcen shtratin dhe muret e shtëpisë.

Syri i mprehtë i lundërtarit brend larg.

Besojini Xhemalit me një sy.

Prisni këmbanën herën tjetër.”

Këtë mëngjes, para Xhemal Syçit, kanë mbërritur dy gra të reja.

Ato janë ulur në rërë buzë detit dhe, ashtu të ngrira, kanë hedhur vështrimin larg, në horizont.

Xhemal Syçi i përshëndet me mërmëritje dhe nis të ngjitet, duke numëruar pa zë shkallët; dihat i lodhur që pa u ngjitur as gjer në mes.

Ngatërruar me numërimin që bën çdo mëngjes pa u ndjerë, i shfaqet edhe një si ngërç trishtimi brenda vetes.

Pamja e pritjes atë e bezdis.

I sjell ndër mend gruan e tij, Miriamin.

Ajo ka vdekur një vit më parë.

Mendon se edhe ajo kështu ka gdhirë kushedi sa ditë në pritje të kthimit të tij.

Tani ai, plak i mjerë, nuk ka më dikë që ta përcjellë në mëngjes herët kur del nga shtëpia në rrugëtim dhe ta presë kur të kthehet nga rrugëtimi në fund të ditës.

Buzë deti, pragu i shtëpisë, fundi i rrugës së pluhurosur që mbërrin nga shkretëtira — janë pa Miriamin me fustan të bardhë, ngulur si një flad i bukur përballë tij.

Dikur këto pritje grash i dukeshin të kota dhe të bezdisshme.

Tani që mungojnë, ndjehet i trishtuar — për të nuk ka më pritje.

Po ndoshta ajo e pret në portën e parajsës — hap sytë atje pas dere, kur hapet porta dhe hyjnë lart në qiell shpirtrat e të ikurve.

Pret të shohë Xhemalin të ngjitet edhe ai — në parajsë do të ngjitet pa tjetër, — e meriton atë.

Po t'i takojnë sytë tek njeri-tjetri, kjo do të thotë se edhe ai ka vdekur.

Sa mirë.

Do të jenë bashkë.

E pra, ai është gjallë.

Nuk ka vdekur gjatë natës.

Gjallë është ngritur dhe po ngjit shkallët e kullës së farit edhe këtë mëngjes.

Xhemali beson se do të vdesë në errësi.

Po nuk vdiq natën në gjumë, vështirë të vdesësh në mëngjes me dritë.

Në mëngjes, gëzohu se e fitove edhe një ditë jetë më shumë.

Allahu është bujar.

E ka lënë gjallë të shijojë këtë ditë të re.

Të thithë ajrin e pastër, thellë e thellë, me vështrim nga deti.

Edhe këtë mëngjes numëron pa zë dhe ngjitet lart — atje ku hapësira shpaloset e pafund.

Numëron edhe shkallën e fundit.

Eh, ia mbërriti.

Tridhjetë e dy shkallë.

2.

Qenka ditë me fat.

Atje larg në horizont shfaqet vezullimi i zbehtë i bardhë i një vele. Po vijnë.

Shpërndahet në ajrin e bardhë të mëngjesit drita e bardhë e velës nëpër erë. Gufon.

Një velë e bardhë trazon gëzimin dhe zgjon nga gjumi gjithë banorët e qytezës së vogël.

Erdhën.

Po vijnë.

Xhemal Syçi i bie fort këmbanës.

Këmbana sa herë që dikush mbërrin tingëllon hareshëm.

Herë-herë Xhemalit i ngjan me zhurmën që, sipas tij, duhet të bëjë rrezja e diellit kur prek gjokset e zogjve të përgjumur e i vë t'ia marrin këngës në zgjim në kor me cicërima.

Herë-herë këmbana tingëllon si një duartrokitje e fortë në përfundim të një ëndrre të bukur. Rrallëherë ëndrrat përfundojnë për mirë.

Bregu, deri atëherë pothuajse i shkretë — pëshpërisnin vetëm valët — papritur mbushet me zëra të fortë njerëzish që zhurmojnë jetë. Gjallëri.

Heshtja shpupuriset, tretet, fshihet pas thirrjeve të emrave nga bregu për t'u dëgjuar atje larg, në thellësi.

Shpejt, shpejt.

Erdhën. Erdhën.

Ja ku po vijnë.

Si gjithmonë, më të paduruarat janë gratë.

Nënat vrapojnë si të jenë çupërlina të reja. Kanë harruar ankimet dhe rëndesat e kockave për të cilat janë shtrirë herët në shtrat në natën që kaloi.

Nuset, me burra të munguar, përpiqen t'i parakalojnë nënat e paduruara. Hedhin hapa të mëdhenj, janë më të reja dhe hapat i kanë më të mëdhenj.

Duket sikur është shpallur një garë e heshtur: kush do të mbërrijë përpara deri te bregu, nënat apo gratë?

Fëmijët ngatërrohen nëpër këmbët e të rriturve. Si gjithmonë fëmijët e kanë lojë gëzimin, pritjen, mungesat, ikjet dhe mbërritjet. Ca më shumë. Njësoj i ndiejnë: një lojë.

Burrat, që kësaj radhe nuk kanë dalë në det, vijnë nga pas të pangutur, e përjetojnë gjithçka që ofron jeta si një gjë të rëndomtë.

E ç'është një mbërritje që përjetohet si një festë?

Të gjitha anijet që ikin, një ditë vijnë. Normale.

Mos e teproni tani me emocione të kota. Lërinini për ndonjë ngjarje të rrallë.

Është gabim të rrahë zemra kaq fort për një kthim të rëndomtë.

Çfarë mbetet kur anija të thyhet gjallë nga lufta apo stuhitë?

Midis njerëzve që vrapojnë drejt bregut është edhe Maja.

Maja është fytyrë-mbuluar, por të gjithë e njohin nga ecja e saj.

Ka hijen e një hijene kur vrapon.

Me hapa të mbështetur dhe trupin e derdhur, kur ecën duket si një velë që e shtyn era.

Maja është gruaja e Arnautit, kapedanit të piratëve.

Me Arnautin ka kaluar tre ditë të nxehta pasi ai e rrëmbeu tinëzisht nga tenda e shkretëtirës ku banonte.

Tre ditë e tre netë të nxehta, për t'u ndarë më pas për dy muaj me radhë, kur ai me anijen e tij është endur nëpër detra.

Arnauti e ka shpallur Majën gruan e tij dhe e ka lënë në shtëpinë e madhe ku banonte i vetëm.

Gruaja!

Më mirë ta quash pengu!

E ka përplasur aty dhe ia ka mbathur për gjueti në shtatë detra.

Tre ditë dashuri e zjarrrë.

Dy muaj vetmi.

As ajo vetë nuk e di çfarë emri t'i vërë vetes: grua apo robinjë.

Teksa vrapon drejt bregut të detit ka ndjesinë se nuk do ta njohë Arnautin kur ta shohë të zbrësë nga anija.

Për dy muaj është duke ia harruar portretin.

E mban mend nxehtësinë e trupit të tij, i ka të vizatuara trajtat muskuloze të krahëve, trupin e rëndë shtypës, rrëshqitës, mbështjelljen e krahëve, të kofshëve dhe përpëlitjen e trupit të saj të brishtë aty midis.

Portretin e tij nuk e mban mend mirë.

Përditë ka harruar diçka nga tiparet e tij, që edhe ato tre ditë nuk ka pasur kohë t'i fiksonte mirë. Gjëra të tjera mban në kujtesë dashuria.

Në përfytyrimin e saj, portreti i Arnautit është bërë dalëngadalë i ngjashëm me portretet e rëndomta të shumë burrave të tjerë, fshehur pas vetullave të trasha kaleshe, flokëve kaçube dhe mjekrës së dëndur të pakrehur.

Vetëm kur ka dëgjuar këmbanën që lajmëronte se ai është gjallë dhe po kthehet ka ndier një gëzim të lehtë, që edhe pak po të vonohej kthimi, asnjë grimë hareje nuk do të mbetej — do të shuhej, pa lënë gjurmë do të tretej.

Gjatë gjithë këtyre muajve të mungesës Maja më shumë është ndjerë e tërbuar.

Ka fantazuar me mendjen e saj se si ai tjetri kushedi çfarë aventure të nxehtë jeton kur ikën larg.

Kushedi në çfarë toke ka zbritur dhe ka zënë ndonjë grua tjetër.

Thonë se marinarët në çdo skelë ku mbërrijnë kanë nga një grua. Ndonjëri edhe dy a tre.

Dy muaj janë koha e mjaftueshme për të harruar tre netët e zjarra të kaluara së bashku dhe për të nisur një dashuri të re.

Kushedi sa herë Maja ka thënë: *mos e sjell të kokën!*

Dhe ja, tani të gjitha janë përmbledhur në një fjali që pëshpërit me mllef:

“Erdhe më në fund? Më mirë të kishin ngrënë peshqit.”

Këtë moment të ardhjes e ka përfytyruar në mendime shumë herë dhe gjithmonë në të njëjtën mënyrë: nervoze dhe e paqartë.

Edhe këtë çast, në vrap e sipër, flet me vete —
në çdo hap nga një frazë, me ritëm:

“Dëgjomë mua, unë jam rritur e lirë.

Në atë fisin tim në shkretëtirë gratë i adhuronin.

Perëndia më e dashur kishte emrin e një gruaje.

Ti më rrëmbeve dhe unë nuk të kundërshtova.

Të besova. Të besova për mirë.

Por më sqaro një herë e mirë:

Më rrëmbeve të më kishe pranë, apo më
rrëmbeve për të më lënë kështu të vetmuar?

Të vetmuar si një kokrrizë rëre në mes të
shkretëtirës.

Ma sqaro këtë gjë para se unë të arratisem.

Do iki përsëri te të mijtë dhe do t’i sjell këtu të
të tregojnë ty vendin.

Dua të bisedojmë e t’i ndajmë gjërat njëherë e
mirë.”

Të gjitha këto i bluan përsëri me vete, ja kështu,
me fjalët që vrapojnë të arrijnë njëra-tjetrën në
ngutin e vrapit të saj drejt bregut.

Zgjat shumë pak e gjithë kjo marramendje
fjalësh, deri në momentin kur anija lëshon spirancën.

Marinarët lidhin litarët në breg dhe piratët
fillojnë të zbresin.

Kur Arnaut Mami shkon drejt Majës, papritur
të gjitha mendimet e saj fashiten si të mos kenë
qenë kurrë.

Humbin fjalët e shumta, mallkimet, sharjet, dhe
mbetet vetëm një përqaqim dhe një rotullim në ajër,
duke u hargalisur.

Një pëshpëritje e ëmbël është përfundimi i asaj
vorbulle mendimesh të rrëmujshme:

“Mos më mungo kaq shumë herë tjetër. Mirë?”

Arnauti kënaqet nga fjalët që ajo thotë me zë të shuar, dhe po me pëshpërti flet edhe ai:

“Je ti që më ke munguar. Ta dish. Do ta marr bakun.”

Pastaj puthen nën çarçafin që mbulon fytyrën e Majës, përqafohen pa fjalë duke u rrotulluar, vetëm duke nxjerrë psherëtima dhe rënkime.

Edhe kafshët e shkretëtirës nuk kanë drojtje kur pleksen me njëra-tjetrën e nuk fshihen. E përse duhej të fshiheshin ata nga turma që i vështron shumica me zili?

Puthjet e tyre i përçmojnë vetëm shpirtrat ziliqarë.

Me ziliqarët Arnauti tallet. Thotë se kanë zemra të plasaritura, si toka e tharë ku kanë kohë që nuk kanë rënë shirat.

3.

Pasi çmallen e zhgryhen mirë e mirë, Arnauti e përcjell Majën drejt shtëpisë dhe vetë kthehet sërish në anije.

Është momenti i bukur kur do të nxjerrin para të gjithëve çfarë kanë sjellë nga larg — trofetë nga sulmet e tyre prej piratëve të rrezikshëm.

Nxjerrja e mallit dhe e njerëzve të grabitur tashmë bëhet sipas një rituali të përcaktuar.

Më parë gjithçka bëhej rastësore, por nga që ky moment shfaqet para syve të shumë njerëzve, është paracaktuar një lojë skenari, sipas të cilit gjithçka që do të ndodhë dihet.

Veprimet rastësore fillestare janë plotësuar me sjellje të përsëritura herë pas here pas çdo grabitjeje, dhe tani gjithçka është bërë normë e detyrueshme për t'u zbatuar.

Në heshtje është vendosur një kod i pathyeshëm nga i cili nuk largohesh dot.

Në fillim zbret nga anija dhe prin kapiteni, që në këtë rast është Arnauti.

Kapiteni mban të gjitha shenjat dalluese të një pirati.

Spikat kapelja e përthyer me shenjat e vdekjes: një kafkë dhe dy kocka.

Kapelen duhet ta ketë domosdo të vendosur në kokë për të mbuluar edhe flokët, të cilët shumicën e rasteve qëllojnë — ja kështu si tani — të shpupuritur, të pakrehur.

Kapelja ndihmon për të dhënë përshtypjen se brenda saj flokët kanë pamje të rregullt.

Kapiteni mban në dorë, kryqëzuar në gjoks, dy shpata dhe udhëheq kortezhin e robërve.

Robërit janë të lidhur të gjithë në një litar të përbashkët.

Pas tyre vijnë të lirshëm piratët e tjerë luftëtarë të anijes, që, falë qiellit, kapedani i ka kthyer në tokë gjallë nga deti që është i paparashikueshëm për çdo udhëtim.

Floririn dhe sendet me vlerë të grabitura në fillim i nxirrnin në breg dhe i ndanin përpara robërve. Tre marinarë mbanin arkat e hapura që shndrisnin.

Por kjo mënyrë e ndarjes së plaçkës ka sjellë edhe sherre, dhe jo pak herë sherret kanë përfunduar në trazira me të vrarë; prandaj kjo pjesë është ndryshuar me kalimin e kohës në ritualin e mbërritjes.

Plaçkën e ndajnë që më parë në anije, ku mundësitë e kundërshtimit janë më të kufizuara dhe secili është i detyruar të pranojë çfarë i japin për hise, pa u ndjerë dhe pa kundërshtime.

Kështu që, në sytë e turmës që ka mbërritur në breg për të pritur të afërmit apo thjesht për të bërë sehir apo ndonjë pazar, parakalojnë vetëm sklleverit.

Sklleverit janë të drobitur. Duket që i kanë mbajtur keq në anije.

Rrobat e zhubravitura e shtojnë pamjen e tyre prej të munduri.

Kapedan Arnauti është i rreptë dhe fjalëpak.

Jo se nuk e di gjuhën arabe mirë, nga që ka ardhur nga larg, prej Ulqini, por kështu ka tipin.

Kur nxjerr një fjalë, duhet ta dish se më parë ka bërë me vete pa u ndjerë tre veprime: — ka menduar heshturazi çfarë do të thotë, — ka analizuar fjalët për të evituar keqkuptimet, — ka përshtatur fjalorin për dëgjuesit që ka përballë. Pastaj nxjerr zë.

Edhe veprimet i përcakton më parë, pa fjalë, me veten.

Konkluzionet kërcejnë nga një breg në tjetrin, dhe spirancën e lidhin gjithmonë rrufeshëm aty ku zgjohet instinkti.

Mënyra se si Arnauti po i prin robërve ngjason me ecjen triumfale të një luani, kur i ka nënshtuar pas vetes kafshët e tjera të shkretëtirës.

Gjoksin përpara, dorën te shpata që mban në brez, vështrimin lart si prej një monumenti.

Kjo pamje është triumfuese për luanin dhe poshtëruese e e pashpresë për kafshët e gjora të mundura apo të zëna pre, që vijnë kokëulur, gjokset e varura, duart e lidhura në një litar të përbashkët.

Ato shkojnë pas tij të bindura, edhe duke e ditur se kështu shkojnë drejt një fati të keq, drejt vdekjes.

Nuk kanë zgjedhje tjetër. Dhe kjo duket në të gjithë mizanskenën.

I pari që ecën në rreshtin e robërve është një burrë i imët, fytyrë-vrerosur.

Ka një mjekër të hollë, të mprehtë, të ujdisur dhe një pamje të drobitur.

Edhe pse i lidhur, duket që ky njeri e mban mirë veten dhe kujdeset të duket sa më i fisëm përtej robave të zhubravitura.